



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____ /2019
Dt.03.06.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 1. Paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mbledhjen e mbajtur me dt.03.06.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 14 të rendit të ditës: Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për Objektivin e ish BANKOS-it i cili menaxhohet nga AKP-ja që është i ndërtuar në pjesët e parcelave P-70705029-00560-1 dhe P-70705029-00562-3 ZK Gjakovë Qytet, në pronësi të P.SH. Kuvendi i Komunës së Gjakovës e miratoi këtë:

V e n d i m **Për Shpalljen e interesit publik .**

1. Shpallet Interesi të përgjithshëm në objektin e ish – BANKOS-it i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesët e parcelave kadastrale me P-70705029-00560-1 dhe P-70705029-00562-3 zona kadastrale Qytet Gjakovë në pronësi të P. SH Kuvendi i Komunës së Gjakovës.
2. Qëllimi i shpalljes së Interesit përgjithshëm në objektin e ish – BANKOS-it i cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) e që është i ndërtuar në pjesët e parcelave kadastrale me P-70705029-00560-1 dhe P-70705029-00562-3 Zona Kadastrale Gjakovë Qytet në pronësi të P. SH Kuvendi Komunës Gjakovë, bëhet me qëllim të marrjes në pronësi dhe administrimit të objektit të ish – BANKOS-it për nevojat e administratës së Komunës së Gjakovës .
3. Autorizohen organet e Administratës Komunale që të zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara ligjore për realizimin e këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë,
- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
- Arkivit.



Kuvendit të Komunës

Anton Shala